

Dalës-izlazna

Nr. I-138
Br.

Data 18.09.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic


Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e 12) me dt.26.09.2018 (e mërkurë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021
4. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e mjeteve në kategorinë paga dhe meditje (DEFZH)
5. Shqyrtimi i kërkesës së Handikos-it
6. Shqyrtimi i kërkesës së BIK-ut
7. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Dalës-Izlozja

Nr. I-127
Br.

Data
Datum

31.08.2018

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

OBILIQ-OBILIC

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.08.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Qëndresa Dubova, Florije Jashari, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlja, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Përparim Klinaku, drejtor i adm. së përgjithshme, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Ferid Hashani, drejtor i bujqësisë, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Avdyll Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, përf. e UNMIK-ut

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar i Komisionit vlerësues për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim
4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Babimoc
5. Shqyrtimi i kërkesës së DFEZH-së, për transfer dhe ridestininim të mjeteve, nga vlerat e mbetura të projekteve për vitin 2018
6. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.
Miratohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

1. Pika e parë e rendit të ditës –

Mungoi: Hysni Mjeku, Xhezide Dragusha me arsye, ndërsa Agon Mjekiqi pa arsye

2. Pika e dytë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Ju njoftoj se bashkëpunëtorja për punë të Kuvendit ka qenë në pushim vjetor dhe këtë ekstrakt e kanë punuar zyrtarët tjerë.

Aziz Bici – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar sepse mungojnë fjali e paragrafe të tëra, nga ajo që diskutohet dhe është humbë krejtësisht kuptimi i diskutimit. Tani po i sjellë disa shembuj sa i përket shqyrtimit të planit veprues 2018 – 2021, në përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është vetëm gjysma e asaj që unë e kam thënë duke munguar pjesë të tëra si:

Në këtë mënyrë siç po shkojmë nuk shohë se do të ketë progres meqenëse, ne në këtë plan po e përjashtojmë pjesën tjetër të popullsisë së Obiliqit dhe po kategorizojmë e po diskriminojmë një pjesë të komuniteteve, në baza të etnisë së tyre. Gjithashtu, një indikator që kjo krejtë mungon shumë i fuqishëm negativ që ndër tjerash lexova në planin lokal të veprimit ishte dukuria e të pasurit një grupi të madh të nxënësve serbë rreth 240 nxënës, të cilët punojnë me planprogram të Serbisë, që kjo dukuri është e papranueshme dhe si e tillë sjellë ndasi dhe diskriminim. Deri më tani shihet se nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim nga niveli lokal i qeverisjes. Ndër tjerash, mungojnë fjali të bashkëbiseduesit z.Hysni Mjeku, i cili shprehet në kundërshtim me opinionin tim, duke thënë se së paku ne duhet tua besojmë komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian meqenëse, kemi qenë në të njejtën gjendje si ata, duke

krahasue kështu të kaluarën e popullit shqiptar të nënshtruar e keqtrajtuar nga pushtuesit serbo jugosllav me atë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, në ditët e sotme në Kosovë. Gjithashtu, kundërshtimi im lidhur me këtë temë dhe votimin tim kundër këtij plani e ndërlidhi me faktin e keqpërdorimit të mjeteve, që aktualisht ndahet për këto komunitete, i cili faktikisht është përmendë nga unë në seancën e kaluar të Kuvendit, por nuk figuron askund në procesverbal. Sa i përket pikës së 4, të rendit të ditës të seancës së kaluar mungojnë fjali psh si mund të fillohet zbatimi i një projekti nëse, ai projekt para së gjithash nuk është në gjuhën shqipe. Ne kërkojmë që përderisa kontrata nuk është e përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe të ndërprehet procesi i bashkëpunimit. Pastaj, në procesverbal kërkesa ndaj drejtorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural për sqarime shtesë rreth kriterëve të aplikuar për përzgjedhje të përfituesve nga Komisioni, është shkruar me një fjali të shkurtë dhe krejtë të pakuptueshme, si Azizi, kërkon sqarime shtesë. Gjithashtu, nuk figuron arsyeimi i kësaj çështjeje nga z.Burim Gërguri, përgjegjen e të cilit po e citoj lidhur me subvencionim: "Komisioni ka punuar me Rregulloren për subvencion". Në rastet kur ne pyesim konkretisht rreth çështjeve të caktuara duhet cekur ashtu siç i themi pa ndërhyrje, pa minimizime të fjalive, siç po shohë që po ndodhë në procesverbal duke e humbë krejtësisht kuptimin e asaj që diskutojmë dhe konkluzat. Në fund një pyetje ia kam drejtuar Drejtorisë së Arsimit:

Ndërsa është i habitshëm dhe shqetësues numri i madh i mungesave të nxënësve, në të gjitha nivelet e edukimit shkollor e sidomos në atë të mesëm, një dukuri e tillë bën të dyshohet se organet e shkollës nuk janë funksionale sepse kjo dukuri mund të luftohet lehtë me anë të marrjes së masave konform rregullave të shkollës, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesin. Kërkoj që këto të vendosen në procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Burim Gërguri – Citon nenin 46, pikën 3, të Rregullores së punës së Kuvendit rreth procesverbalit. Unë fillimisht ju tregova se zyrtarët tjerë, e kanë punuar shkurtë procesverbalin dhe nuk ka pasë ndonjë tendencë në këtë drejtim.

Nazmi Gashi - Unë pajtohem me atë që u tha dhe po them se zyrtarja e meriton një falenderim të madh për punën që po e bën sepse vërtetë me lexue procesverbalin e mbledhjes së kaluar me shumë gabime, me shumë të meta dhe njerëzit nuk kanë mund me mbërri me dhënë atë që ne e kemi thënë. Unë nuk po kërkoj me denue askend, por po shihet çka do të thotë me pasë një zyrtar profesional që ta ndihmon dhe lehtëson punën.

Burim Gërguri – Bazuar në nenin 48, të Rregullores së punës së Kuvendit evidentohen vërejtjet e dhëna rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet e cekura më lartë.

3.Pika e tretë e rendit të ditës -

Burim Gërguri – Tani për sqarim fjalën ia japë drejtorit të administratës së përgjithshme, i cili ka qenë edhe Kryetar i Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Përparim Klinaku – Sqaron se Komisioni punën e vet e ka bërë duke u bazuar në vendimin e Kuvendit komunal, Ligjit nr.04-L-144, neni 8 dhe 6 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe Rregullores nr.23 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme komunale. Ne si Komision pasi që kemi pranue listën e pronave për dhënien në shfrytëzim kemi shpallë konkursin publik sipas ligjit, afati për aplikim ka qenë 45 ditë dhe në bazë të raportit që kemi mbledhë kemi pasë 10 aplikues. Ju kërkoj falje për një lëshim të vogël që na ka ikë për të cilin do të ju japë nga një kopje të procesverbalit të përmirësuar të dt.25.07. Te prona që ka konkurue "Agrokor" me ngastër 7261405501790, ju e keni 600,000, që në fakt është 500,000 euro, ndërsa numri i punëtorëve është prapë i njejtë. Poashtu, prapë te "Agrokori" te prona 72614055-01790-11, te vlera e investimit prapë e keni 600,000 që faktikisht është 2 milion e 580,490 euro, ndërsa numri i punëtorëve është prapë 80.

Burim Gërguri – Pyet se a ndikojnë në raportin përfundimtar këto vërejtje teknike që i paraqite.

Përparim Klinaku - Përgjegjet se ky ndryshim nuk ndikon në raportin përfundimtar sepse te parcela e fundit që e ceka, aty kemi pasë ankesë se kanë qenë 2 aplikues. Aplikuesi i parë "Las Pallmas" i ka me 300,000 euro, plus 6 punëtorë, ndërsa "Agrokori" e ka me 500,000 euro, me 80 punëtorë dhe në nenin 13 të Rregullores janë të parapara procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e ofertës më të suksesshme.

Burim Gërguri – Duhet të bëjmë një sqarim se këto toka kanë qenë në shfrytëzim, njerëzit i kanë marrë para 10 viteve dhe i kanë bizneset ekzistuese, por sipas ligjit duhet prej fillimit me startue.

Përparim Klinaku – Sqaron se është e vërtetë se të gjithë ata që kanë aplikue për këto prona, janë shfrytëzues aktual, por sipas ligjit nuk ka ndonjë favorizim të caktuar. Ne i kemi pasë këto oferta dhe nuk ka konkurue dikush tjetër sepse sikur të kishte konkurue dikush tjetër për cilëndo parcelë, ne është dashur me zbatue Rregulloren dmth kriteret e përzgjedhjes.

Nazmi Gashi - Pyet se vendimi i Kuvendit a përputhet me atë se të gjitha pronat kanë kalue në proces, në procedurë afatgjate 99 vjeçare.

Përparim Klinaku - Përgjegjet se unë jorastësisht e përmenda se puna e Komisionit është e bazuar në vendimin e Kuvendit komunal dhe këto prona janë dhënë në shfrytëzim prej 15-99 vjet në bazë të vendimit.

Fatos Kurshumlija – Edhe unë deshta me pyet se a kanë qenë më heret në shfrytëzim këto prona apo tash, që kjo çështje tani u sqarue.

Lulzim Sadiku – fillimisht po duket se këto prona janë dhënë nga viti 2005 dhe njerëzit që i kanë marrë këto prona, kanë ofruar oferta se do të bëjnë me këtë shërbim, me kaq punëtorë. Ju a keni kërkuar kur ju ka dhënë prona këtyre njerëzve në vitin që i kanë marrë, se a i kanë përmbushë kriteret që e kanë marrë pronën shtetërore. Mendoj se atëherë këta që e kanë marrë këtë pronë, e kanë ofruar një ofertë se punësojnë 20, 40, 80 punëtorë dmth a ka kërkuar Komuna e Obiliqit, nga ata që të na e sjellin listën e punëtorëve, të cilëve ua ka pague trustin dhe ka kontratë nga viti paraprak të cilët e kanë marrë dhe e shfrytëzojnë pronën shtetërore. Ju si Kryetar i Komisionit, a keni të dhëna të sakta, valide që të na bindni që ne të votojmë për dhënien e këtyre pronave pronarëve, të cilët kanë biznese të ndryshme.

Aziz Bici – sipas raportit përfundimtar vërehet avazi i vjetër i ndarjes së parcelave tokësore të Komunës, në bazë partiake, militante dhe në bazë përfituese personale. Mirëpo, para se të flasim për përfituesin do të doja ta sqaroj fjalinë “oferta më e favorshme ekonomike”, të cilën e keni cekë para emrit të secilit përfitues dhe kjo a nënkupton se për secilën ngastër ka pasë disa ofertues, apo e njehta fjali është përdorë edhe atëherë kur ka pasë vetëm një ofertues. Këtë e them sepse dokumentacioni na bën të kuptojmë se janë vetëm 3 ofertues të refuzuar dhe kjo nënkupton se për disa ngastra ka qenë vetëm një ofertues. Kjo nuk është ligjore nëse, i referohemi ligjit në fjalë respektivisht nenit 5 të ligjit, pika 1: “Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohen përmes konkurrencës së hapur publike dhe procedurave të parapara me këtë ligj”. Përfituesi “Burimi” Sh.p.k. sa e di unë zona në të cilën ky përfitues funksionon dhe ku ka fituar këto ngastra është zonë hotelierie, ndërsa aktiviteti i tyre është gërmimi i zhavorrit dhe betonjere. Në dokumentet që i kemi pranuar thuhet se ai do të investoj 800,000 euro dhe do të punësoj 39 punëtorë, ose në total 50 punëtorë. Sa i përket ngastrës kadastrale prej 10503 m² që e ka fitue z.Sami Saraqi, prapë ne nuk dijmë se në çka do të investohet përveç asaj se do të investohen mbi 1.5 milion euro dhe do të punësohen 19 punëtorë. Projekti i ndërtimit të çerdhës në Milloshevë, u zhvendosë në Mazgit sepse u tha se nuk ka pronë komunale në Milloshevë dhe nga doli tani kjo pronë dhe a konsideroni se është më e vlefshme çerdhja, apo investimi i panjohur që do të bëjë Sami Saraqi, për banorët e Milloshevës dhe Obiliqit. Sa i përket përfituesit Poligoni i shenjëtarisë “Katana” është veç se e njohur se pronari i vërtetë i këtij biznesi është Kryetari i Komunës. Kjo në vetvete përbën shkelje ligjore, konflikt të interesit dhe mund të konsiderohet akt më skandaloz që ka bërë një Kryetar Komune, duke përvetësuar mbi 1 ha pronë komunale, me një zotim të pakonfirmuar të investimit mbi gjysëm million euro dhe të punësimit të 13 punëtorëve. Ne si LVV, e konsiderojmë këtë akt si shkelje ligjore, konflikt interesi dhe si e tillë do të sigurohemi të përdorim çdo mjet ligjor e juridik. Me pak fjalë pyetjet që ju parashtruan anëtarëve të Komisionit për secilin investitor përfitues përfshihen “Burimi Sh.p.k” “NTP Union”, “Agrokor Sh.p.k” “Poligoni i shenjëtarisë Katana” Sh.p.k. dhe Sami Sqraraq, janë:

Ju nuk na keni informuar se cili do të jetë aktiviteti i tyre, në çka do të investojnë ata, cilat janë afatet kohore të investimit, cilat janë garancat e ofertuesit se do të bëjë investimin në fjalë, çka nëse ai nuk do të

bëjë atë investim, punëtorët që do të punojnë aty, a do të jenë nga Obiliqi, apo do të ndodhë si gjithnjë. Banorët tonë përballojnë ndotjen dhe çdo gjë tjetër ndërsa, përfitimin dhe punësimin e fitojnë banorët e Komunave tjera. Nga 3 subjekte, që ju janë refuzuar ofertat janë: “Inkstation” “Kolegji biznesi” dhe “Las Pallmas” që sipas dokumenteve të bashkangjitura vetëm kjo e fundit paska bërë ankesë me dt.22.08.2018, e cila qenka shqyrtue me dt.28.08.2018. Megjithatë, në materialet e bashkangjitura janë vetëm dokumentet e Komisionit, por jo edhe ankesat e Komisionit dhe shpresoj që kjo gjë të mos jetë e qëllimshme. Mosfunksionalizmi i instancave më të larta dhe ligjeve në fuqi, mungesa e referencave të këtyre investitorëve, dëshmojnë joseriozitetin e tyre duke vënë kështu në dyshim besimin ndaj tyre. Gjendja e tillë shpjegon qëndrimin tonë negativ me votën “Kundër”.

Fatmir Bektashi - Pyet Kryetarin e Komisionit, pse në listën e anëtarëve të Komisionit nuk është asnjë emër nga opozita.

Burim Gërguri - Përgjegjet se ju në atë mbledhje nuk keni marrë pjesë, e keni lëshuar mbledhjen, por ne mundemi në të ardhmen këtë vendim me ndryshue dhe plotësue.

Shaip Paloja - Mospjesëmarrja apo lëshimi i seancës nuk do të thotë se nuk mundesh me qenë i përfaqësuar në Komisionin, që të takon dhe nga ju nuk ishte sqarim i mirë. Një Komision me i dhënë pronat në shfrytëzim pa asnjë anëtarë të opozitës, mendoj se nuk është mirë sepse ne nuk kemi qenë të informuar me asnjë kërkesë, as me planin e tyre se qysh mendojnë me zhvillue biznesin në Komunën tonë. Prandaj, ne jemi para një akti të kryer dhe mendoj se nuk është mirë as për vetë pozitën me veprue në këtë formë.

Burim Gërguri – Sqaron se vendimi është i dt.28.02.2018, dhe ne kemi diskutuar edhe atëherë, që besoj se ka qenë një tolerancë e brendshme pozitive dhe opozitive. Komisioni ka punue në mënyrë transparente dhe unë kam kërkuar edhe material shtesë me na sjellë nga takimet e Komisionit, që ne si kuvendarë me qenë të bindur.

Përparim Klinaku – I përgjegjet z.Lulzim Sadiku, se detyra eksplicite e Komisioni ka qenë përzgjedhja e ofertës ekonomikisht më të favorshme duke u bazuar në nenin 13 të Rregullores. Sa i përket asaj se a do të vijnë punëtorët e Obiliqit, apo të Komunave tjera, kjo çështje do të rregullohet më vonë përmes kontratës në mes të Komunës dhe përfituesve të këtyre parcelave. Tani, i përgjegjem z.Aziz Bici, se në rastet kur ka pasë 2 oferta për një parcelë, ne kemi zgjedhë atë e cila ka qenë më e favorshme për Komunën. Në rastet kur nuk ka konkurue edhe dikush tjetër në atë parcelë, ne kemi rekomandue atë ofertë që e kemi pranue. Afati për aplikim ka qenë 45 ditë, nga dita e shpalljes së konkursit publik, ka qenë në web faqe të Komunës, në tabelën e shpalljeve dhe gjithçka ka qenë transparente.Në pyetjen se a është më mirë me bë çerdhe apo çka investon dikush tjetër, kjo nuk është detyrë e Komisionit me vendosë. Unë i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta votojnë raportin që ne e kemi nxjerrë për dhënjën e pronave në shfrytëzim duke ju falenderuar paraprakisht.

Lulzim Sadiku – Unë fillimisht e kuptova se të gjithë këta pronarë të firmave janë pronarë që kanë marrë tokën në vitin 2005, si ofertues shumë serioz të cilët kanë premtue dhe e kanë marrë pronën për shkak se kanë ofrue opzione, që do të punësojnë kaq punëtorë. Këtu, edhe pse u tha se janë të gjithë të vjetër, unë po e shohë këtu një ofertues, që nuk është i vjetër “Kolegji biznesi” që në Komunën e Obiliqit nuk ka ekzistue, por duket se vërtetë është ofertues i ri. Ne si grup parlamentar mendojmë se nëse, Komisioni e ka vlerësue këtë punë kështu, atëherë ka bërë shumë gabim të madh dhe po qe se nuk i sjellë kontratat e punëtorëve, që nga viti kur i kanë marrë pronat dhe ti dëshmon me trust pensional se ata punëtorë që janë premtue se do të punësohen në vitin kur janë marrë, atëherë ne do të jemi kundër dhënies së kësaj prone.

Aziz Bici – Pyet se a e dini se cilat janë aktivitetet e tyre që do ti zhvillojnë ata dhe cilat janë afatet kohore për zotimet që i kanë bërë. Poashtu, pyes se cilat janë garancitë se ofertuesi në fjalë se do ti bëjë investimet dhe çka nëse, ai nuk i bën ato investime.

Përparim Klinaku – Përgjegjet se këto çështje rregullohen me kontratë dhe këto janë të parapara me ligj dhe me Rregullore, se si do të procedohen në afate të caktuara kur të nënshkruhet kontrata në mes të Komunës dhe përfituesve të parcelave. Nëse, në kontratë parashihen kriteret që ju i përmendët edhe unë jam për punësimin e punëtorëve nga Komuna jonë, por kjo është çështje që rregullohet me kontratë, jo në

këtë fazë. Pra, sipas Rregullores kjo rregullohet në të ardhmen me kontratë për afatet, dinamikën e zhvillimit të projekteve të punës, që ata i kanë. Nëse, nuk e zbaton kontratën një përfitues i parcelës, nëse nuk e realizon projektin brenda afatit që ai zotohet me kontratë, atëherë automatikisht shkëputet njëanshëm kontrata nga ana e Komunës.

Lulzim Sadiku - Pronarët të cilët nuk po akuzoj, as nuk po paragjykoj që i kanë marrë pronat në vitin 2005, ata janë pronarë prapë dhe kur e kanë marrë këtë ofertë atyre nuk ju ka ndërpre kontrata, por po ju vazhdohet. Unë pyes se a e kanë realizue projektin dhe punën që e kanë kërkuar se do ta bëjnë prej kohës e deri më sot, që ne tua vazhdojmë përsëri.

Aziz Bici – Mendoj se Komisioni dhe Kryetari i Komisionit nuk e kanë lexue mjaftueshëm ligjin dhe për fat të keq nuk kam arritë me lexue as unë sepse kur e kisha lexue do të ndihmoja rreth kësaj çështjeje. Mirëpo, nga logjika del se ligji është dashur me parapa afatet kohore për zbatim dhe këtu nuk kemi informacion. Unë dyshoj në përpilimin e kontratës në të ardhmen, po edhe kur i ndërprehet mandati në rast të investimit këtu, nuk është e bazuar në ligj, por është e bazuar më shumë në momentin se diçka duhet me dhënë përgjegje. Unë kisha me thënë që herave tjera të vini më të përgatitur, që të ju mundësoni edhe atyre, që janë në dyshim me votue sepse për ne që mendojmë se do të votojmë “Kundër” kjo nuk mjafton. Mirëpo, sidomos për ata që mendojnë se duhet me votue, ju nuk jeni të përgatitur mjaftueshëm për me i bind.

Nazmi Gashi - Kurrë më i papërgatitur se sot nuk jam ardhë, por megjithatë jam i detyruar nga përvoja të japë një mendim që besoj se ia vlen. Unë e di vetëm një rast është “Burimi” këtu, që e ka pasë një betonjerë në Babimoc dhe ai i ka marrë sendet e veta e ka mbetë batall. Qëllimi i dhënies së pronave është për me bë një zhvillim ekonomik, me i ndihmue Komunës, me bë një punësim dhe me fitue diçka. Mendoj se kontratat që kanë qenë nga viti 2005, Komisioni është dashur me i kontrollue, korrigjue dhe me pa se ato marrëveshje, a janë plotësue deri dikund për me mund me përfitue një përvojë në ripërtrijen e kontratave, që me pasë një arsytim më të kapshëm. Përndryshe, ne do ti japim edhe pronat tjera, sepse është detyrim ligjor dhe kërkesë ekonomike, për neve. Unë nuk e di se Komisioni këtu, sa ka mund me krye këtë punë, sa ka pasë kohë dhe nuk besoj se nuk e ka pasë qëllimin e mirë me dalë në fund me një rezultat, por ka mund me pasë edhe lëshime. Unë besoj se në të ardhmen ka mundësi të bëhen disa përmirësime.

Burim Gërguri – Kërkoj nga drejtori që secili asambleistë me pasë nga një dosje prej hapave të parë që janë marrë dhe zhvillimit të procedurave sepse këta kanë me qenë ata, të cilët kanë me monitorue atë Komision.

Përparim Klinaku – Sqaron se në këtë rast nuk ka vazhdim kontrate, por përfituesve të këtyre parcelave që janë shpallë, ju ka skadue afati në vitin e kaluar dhe këtu, ka pasë konkurs të ri. Ligji i parashehë të gjithë të barabartë në konkurs dhe nuk ka kurrfarë rëndësie se a e ka shfrytëzue pronën më heret apo jo. Sipas nenit 18 të Rregullores, thuhet se raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues përmban një kopje të shpalljes publike të konkursit, procesverbalin e vlerësimit të ofertave, rekomandimin e Komisionit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme, një kopje të protokoluar të ofertës së përzgjedhur dhe ankesat e parashtruara. Te pika 7, e këtij neni është e përcaktuar kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, që nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe nga fituesi i përzgjedhur pasi që të miratohet ky raport përfundimtar prej juve.

Aziz Bici – dua t’ia kujtoj z.Nazmi Gashi, se ky nuk është detyrim ligjor se ne sot duhet me çdo kusht me miratue, por ne jemi të obliguar që pronën tonë tua japim të gjithë investitorëve, të cilët janë të interesuar me zhvillue biznese dhe me zhvillue ekonominë tonë.

Burim Gërguri – Kërkoj sipas ligjit që z.Enver Gashi, ta liroj sallën gjatë votimit për arsye të konfliktit të interesit.

Pas kësaj, z.Enver Gashi e liroi sallën e Kuvendit komunal.

Lulzim Sadiku – Drejtori nuk e ka zbrëthye mirë konotacionin sepse shumë më drejtë do ta kishte sikur të thoshte, po e vazhdojmë kontratën. Paraprakisht unë nuk po paragjykoj se e ka marrë pronari ky apo ai në vitin 2005, por më mirë është të themi se do të ju vazhdojmë kontratën atyre pronarëve, të cilët janë

serioz. Pastaj, të ju kërkojmë këto që i kërkoja unë dhe ti prolongojmë për një seancë, e jo të lidhet konflikt interesi në mes të familjarëve, por të ju vazhdohet kontrata për shkak të këtyre që po i kërkojmë.

Shaip Paloja – unë nuk e kam të qartë, pse e largove z.Enver Gashi, nga seanca sepse nëse është konflikt interesi vllau i Enverit, është z.Xhafer Gashi.

Burim Gërguri – sqaron se konflikt interesi është për njerëzit që janë në vendimmarrje dhe këtu, u përmend “Poligoni i shenjetarisë Katana” që është biznes familjar dhe Kryetari i Komunës, nuk voton por anëtarët e Kuvendit, kështu që unë obligohem me lirue nga salla.

Aziz Bici – edhe pse asnjë referencë këta kandidatë nuk e kanë ofrue para Komisionit dhe po e konsiderojmë si të përfunduar, por pyetja ime është pse me lirue nuk u thirre në ligj dhe në bazë të cilit ligj dhe nen është i obliguar asambleisti me dalë nga salla. Në rast se vërtetë e ke në ligj, unë e kisha respektue, por në rast se don mos me i dhënë rast dikujt me folë, atëherë je duke bërë gabim dhe bën shkelje ligjore. Unë kisha me thënë të kthehet nëse, dikund nuk e ke të shkruar në ligj.

Burim Gërguri – sqaron se në Rregulloren e punës, është konflikti i interesit në nenin 63, që na obligon neve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 9 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 4 vota “Abstenim” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim.

1. **VENDIM**, jepen në shfrytëzim për 99 vite ngastrat kadastrale: P-72602001-00505-5 sipërfaqja 2698 m², P-72602001-00503-1 sipërfaqja 6653 m², ZK Babimoc, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i këtyre parcelave të shpallet “Burimi” SH.P.K.

2. **VENDIM**, jepet në shfrytëzim për 99 vite ngastra kadastrale: P-72614055-01790-24, sipërfaqja 3221 m², ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet N.T.P.UNION.

3. **VENDIM**, jepen në shfrytëzim për 99 vite ngastrat kadastrale: P-72614055-01790-28 sipërfaqja 1891 m², P-72614055-01790-30 sipërfaqja 1004 m² dhe P-72614055-01790-11 sipërfaqja 4502 m² ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet “Agro Kor” SH.P.K.

4. **VENDIM**, jepen në shfrytëzim për 99 vite ngastrat kadastrale: P-72614055-01279-15 sipërfaqja 577 m² P-72614055-01279-10 sipërfaqja 2451 m², P-72614055-01279-7 sipërfaqja 2504 m², P-72614055-01279-4 sipërfaqja 2973 m² dhe P-72614055-01279-3 sipërfaqja 2881 m² ZK Obiliq. Bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i këtyre parcelave, të shpallet POLIGONI i SHENJETARISE “KATANA” SH.P.K.

5. **VENDIM**, jepet në shfrytëzim për 99 vite ngastra kadastrale: P-72614051-00562-1, sipërfaqja 10503 m², ZK Milloshevë, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet ofertuesi Sami Saraqi.

4.Pika e katërt e rendit të ditës –

Aziz Bici – Unë do të jem “Kundër” për arsye se kemi kohë, në rast se kemi ndonjë ofertues serioz në investime, atëherë ne këto formalitete i kryejmë. Prandaj, mos të marrim këso vendime dhe në të ardhmen, të ju krijojmë mundësi investitorëve.

Lulzim Sadiku – Pajtohem me parafolësin plotësisht dhe kërkoj që të prolongohet kjo pikë, për arsye që të shohim se sa po kemi sukses në këto të cilat kaluan në Kuvendin e Komunës. Kërkoj që të prolongohet kjo pikë e veçantë deri në vitin 2019 ose 2020, që ti shohim rezultatet e këtyre të cilët i dhanë.

Burim Gërguri – Sqaron se prona është në shfrytëzim, njeriu e ka investimin dhe është pa kontratë që 6,7 muaj, por ju z.Lulzim Sadiku, keni qenë anëtar i Kuvendit në mandatin e kaluar dhe e dini se në 6 muajt e fundit me ligj, nuk kemi të drejtë me dhënë pronë. Edhe ju si opozitë mund të shihni se qysh është procedue lënda, që i bjen në nëntor ose dhjetor me ardhë në fazën finale, nëse ky vendim shkon në

mënyrën më të mirë të mundshme. Mirëpo, hapat ligjor s'mund ti shkelim për arsye se njeriu është pa kontratë dhe është bërë investim aty.

Aziz Bici – Pyet pse është në kundërshtim me ligjin, në rast se i ka kalue afati sipas ligjit prona i kthehet prapë Komunës dhe kurrfarë obligimi nuk ka Komuna, ndaj atij investitori. Mos u mundoni ti bindni anëtarët e Kuvendit, që në mënyrë të pa menduar mirë, të pastudjuar mirë të ngutemi sepse deri nesër mund të krijohet një ambient shumë më i volitshëm, që të jetë siguria më e madhe edhe në Komunën dhe vendin tonë. Pastaj, mund të vijnë investitorë shumë serioz, qoftë vendor apo nga jashtë, që vërtetë të zhvillohet ekonomia, të vijnë investitorë që kanë referenca të njohura, qoftë vendor apo ndërkombëtar.

Burim Gërguri – Nëse, ia jepë dikujt një pronë dhe ka investime milionëshe, tash me nxjerrë dhe me ia dhënë tjetrit, por ka njerëz që e paguajë edhe atë pjesë. Nuk ka prona që me i dhënë për herë të parë, por ato kanë qenë me një kontratë të caktuar.

Aziz Bici – Unë prapë po them mos të ngutemi me dhënë pronë në shfrytëzim sepse nuk kemi situatë të përshtatshme për investitorë serioz. Këtu, shihet dhe jemi të bindur se po ju japim njerëzve, që ose kanë me lënë batall, ose kanë me ua ndërru destinacionin, ose e kanë qëllimin vetëm për përfitime të ngushta. Prandaj mos na e harxhoni pronën, mos na lejoni me ju hy procedurave ligjore.

Burim Gërguri – Sqaron se ne asnjë veprim antiligjor nuk jemi duke e marrë sepse edhe neve, na monitoron dikush

Lulzim Sadiku – Ne po kërkojmë, që ata të cilët e kanë shfrytëzue pronën shtetërore, a e kanë përmbushë kontratën për pronën, që e kanë shfrytëzue prej vitit 2005-2018. Unë po mundohem të japë një kontribut që Kuvendi komunal, ish Komisioni dhe Komisioni që do të formohet, në fakt atyre që nuk i kanë përmbushë kriteret, të ju vendoset një vijë e kuqe për shkak se e ka shfrytëzue pronën shtetërore dhe nuk ka ofrue asnjë opcion të cilin e ka marrë. Sa i përket asaj se jemi me vonesë, nuk besoj se jemi me vonesë sepse Komuna e Obiliqit, te Gazimestani ka sigurisht mbi 40 ha tokë. Propozoj të prolongohet dhe të formohet një Komision, i cili do të konstatoj se a janë përmbushë kriteret të cilat i kanë ofruar ata kur i kanë marrë këto prona.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 3 vota “Abstenim” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Propozim Vendimi paraprak për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Babimoc (kërkesë e Kryetarit të Komunës)

1.**VENDIM**, jepet në shfrytëzim prej 15-99 vite ngastra kadastrale:P-72602001-01235-0 në vendin e quajtur “KUKË”. Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Bujqësore, kullosë e kl.3. me sipërfaqe prej 23881 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018 e dt.29.06.2018, ZK Babimoc, K.Obiliq e evidentuar si Pronë “P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq”.

2.**VENDIM**, jepet në shfrytëzim prej 15-99 vite ngastra kadastrale:P-72602001-01236-1 në vendin e quajtur “KUKË”. Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Bujqësore, kullosë e kl.3 me sipërfaqe prej 480 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018 e dt.29.06.2018. zk Babimoc K.Obiliq e evidentuar si Pronë “P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq”.

3.**VENDIM**, jepet në shfrytëzim prej 15- 99 vite ngastra kadastrale:P-72602001-01236-2 në vendin e quajtur “KUKË VALOGË”.Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Rajon Ujor, me sipërfaqe prej 18782 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018, e dt.29.06.2018, zk Babimoc, K.Obiliq e evidentuar si Pronë “P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq”.

4.**VENDIM**, jepet në shfrytëzim prej 15- 99 vite ngastra kadastrale:P-72602001-00504-0 në vendin e quajtur “KALDRME”.Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Rajon Ujor me sipërfaqe prej 447 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018, e dt.29.06.2018, zk.Babimoc K.Obiliq e evidentuar si Pronë “P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq”.

5.**Pika e pestë e rendit të ditës -**

Zarife Behluli – Sqaron se fjala është për disa mjete nga projektet kapitale të mbetura, të lira nga grandit qeveritar, nga fondit 21 dhe 22, duke sqaruar detalisht mjetet e mbetura. Këto mjete janë të dedikuara për rregullimin e një fushe sportive dhe për rregullimin e parqeve në Komunën e Obiliqit. Gjithsejt grandit janë 6,921.65 dhe te fushat sportive të lira nga grandit janë 15,78.35, që në total për një fushë sportive janë 32,000 euro. Prej një kontrate që pritet të lidhet kontrata lirohen 23,000 euro, që në total bëjnë 105,877.53, por nëse nuk lirohen 23,000 euro, atëherë mbeten 82,876 për rregullimin e parqeve në Komunën e Obiliqit. Vlera të lira, te fushat sportive janë 6,921.65, që ka prej një projekti në një projekt dhe te rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit në total janë 67, 376.91, ndërsa te fushat sportive janë 6,921.65.

Burim Gërguri – Ju njoftoj se në këtë vit nuk ka pasë rishikim të buxhetit dhe me ligj lejohet një pjesë e mjeteve, me u ridestinue.

Lulzim Sadiku – Mua, më gëzon fakti që kanë mbetet mjetet dhe po ndjehem tepër mirë që kam mundësi të japë një kontribut, që të dijmë vlerën e saktë të bartjes dhe ku parashihen të dërgohen nëpër cilat pika. Këtë, dua ta kemi vetëm si sqarim.

Zarife Behluli – Sqaron se te fushat sportive, ju duhet të ma jepni vendimin që nga sinjalizimi horizontal dhe vertikal 2,623.60, që është te DSHPE-ja, ky projekt me kaluar në Drejtorinë e kulturës. Hartimi i projekteve, është te infrastruktura publike 500 euro, ka mbetje grand, ndërtimi i objektit QKMF, në Milloshevë, janë 30,000 euro grand, por ne atë projekt e kemi fituar me donatorë dhe objekti është ndërtuar dhe këto mjete duhet me i bartë nëpër vijat tjera sepse është grand qeveritar, që nëse mbeten deri në fund të vitit i merrë Qeveria. Te ndërtimi i lapidarëve dhe përmendoreve, është lidhë kontrata, kanë mbetur vetëm 59.97 euro, që është te Drejtoria e kulturës. Pastaj, 6,921.65 bëhen me vendim transferi i mjeteve për me bë edhe një fushë sportive. Ndërsa, te rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit 13.89.37, prej projekteve që i ceka shkojnë te rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit, nga grandit qeveritar 24,479.72, prej fondit 21, të hyra vetanake shkojnë te parqet në Komunën e Obiliqit. Poashtu, nga mjetet e bartura nga viti 2017, në vitin 2018 janë 29,875.32, që në total bëjnë 67,376.91, te rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit.

Lulzim Sadiku – Ndoshta, nuk isha shumë i qartë sepse mua më interesoi shuma totale e mjeteve që do të barten dhe ku parashihen nëpër të gjitha pikat të shpërndahen.

Zarife Behluli – Sqaron se 67,376.91, shkojnë në rregullimin e parqeve në Komunën e Obiliqit, ndërsa 6,921.65 euro, shkojnë në rregullimin e fushave sportive, që është e paraparë edhe një fushë sportive dhe një park.

Shaip Paloja – Pyet se te fusha sportive, a është përcaktuar vendi se ku do të ndërtohet dhe unë nuk e di se çfarë fushe sportive me 6,900 euro, mund të ndërtohet.

Zarife Behluli – Sqaron se për këtë arsye unë ju kam sjellë raportin detaj se sa do të bëhet transferi i mjeteve dhe sa ka mjete. Te grandit qeveritar për fushën sportive janë të lira 15,78.35, në zotim janë 6,652.66 dhe të lira te 21, janë 3,347.34, që në total një fushë është 32,000 euro. Në Mazgit, do të bëhet një park dhe një fushë sportive.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal, unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet rishikimi i buxhetit për vitin 2018.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës -

Burim Gërguri – Lexon kërkesën nga Ndërmarrja Shkabaj Sh.p.k. e cila është kërkesë e ripërsëritur dhe DPUKP, ka dhënë përgjegje të cilën ia kemi kthyer palës. Tani, kemi kërkesën nga DSHPE, për vendosjen e një trafoje për shkollën amerikane dhe lagjen Shkabaj, për të cilën do të na njoftoj drejtori.

Naim Miftari – Lexon kërkesën nga shkolla amerikane dhe i njoftoi të pranishmit se kjo kërkesë i është drejtuar Kuvendit, por është bërë gabim teknik dhe ka ardhë në Drejtorinë time. Prona ku do të vendoset trafoja është pronë komunale dhe hapësira për vendosjen e trafos është 5x5 dmth totali është 10 m².

Shaip Paloja – Sa e di unë aty ku do të vendoset trafoja është pronë e KEDS-it, edhe trafoja edhe vendi përndryshe nuk besoj se mundet me ndërtuar trafon.

Naim Miftari – Sqaron se inxhinjerët e KEDS-it, e kanë paraparë se duhet të vendosen 2 trafo, njëra trafo vendoset aty ku e ka bërë kërkesën shkolla amerikane dhe trafoja tjetër vendoset në parcelën private të shkollës amerikane.

Aziz Bici - Në këtë pikë po flitet për lejimin e vendosjes së trafos, por jo edhe për dhurimin e pronës Komunale, në hapësirën prej 675 m² P-72614055-01790-26, për të cilën pronë kishte aplikuar dhe ishte refuzuar kolegji biznesi. ASK, është institucion arësimor profitabil dhe nuk e kuptoj se cili është interesi i qytetarëve nga kjo dhuratë e Komunës, aq më tepër pse ASK, nuk e ka bërë ofertën si ofertuesit tjerë, por ka bërë kërkesë në DSHPE. Pastaj, drejtori e ka cekë se nga kjo trafo, do të përfitojnë edhe banorët e Shkabaj, Dardhishtë, por a ka zotim me shkrim të ASK-së, se do të lejoj kyqjen e këtyre banorëve të këtyre lagjeve dhe nëse po, pse nuk i është bashkangjitur këtij materiali. Poashtu, keni cekë se trafoja do të vendoset në hapësirën 5 me 5, që mund të jetë gabim teknik sepse në fakt është 25 m², e jo qysh thatë 10 m². Tash, a do të jepen 10 m² nga parcela prej 675 m² apo si do të jepet. Ne si LVV, nuk jemi kundër investitorëve, përkundrazi i mbështesim dhe i inkurajojmë që të investojnë në Komuën tonë. Për çdo gjë publike që dhurohet duhet të arsyetohet, të shihen efektet, apo të mirat që ju kthehen qytetarëve. Nga ajo që ne po dhurojmë derisa nuk janë dëshmitë e cekura më lartë, ne nuk do ta përkrahim ndarjen e kësaj parcele për shkollën amerikane

Naim Miftari – Sqaron se parcela është pronë komunale dhe është e vërtetë se për këtë parcelë ka aplikue “Kolegji i biznesit” dhe totali i kësaj parcele është 6 ari e 75 m.

Burim Gërguri – vendosja e një trafoje është obligim ligjor dhe 5 me 5, është gabim teknik sepse një trafo maksimale i merrë 10 m² dhe ne vetëm po lejojmë me u vendosë një trafo. Tani pyes, ju si Drejtori a e keni shqyrtue që është obligative se ajo trafo do ti shërbej komunitetit dhe shkollës.

Naim Miftari – Përgjegjet se përderisa posedon leje ndërtimore dhe i ka krye të gjitha obligimet komunale, ne jemi të obliguar me ia sigurue hapësirën për vendosjen e trafos. Kjo trafo në të ardhmen do ti shërbej edhe komunitetit që jeton afër asaj shkolle.

Enver Gashi – Unë nuk e di se a janë në pyetje 2 trafo, apo 1 trafo sepse nëse janë 2, njëra brenda në kolegji dhe një tjetër prapë pse, çka po i vyen kur ka mundësi prej njëres me u shërbye edhe komuniteti që është aty.

Naim Miftari – Përgjegjet se për arsye të distances, inxhinjerët e kanë paraparë se duhet të jenë 2 trafo, njëra vendoset në parcelë komunale, ndërsa tjetra në parcelën private të shkollës amerikane.

Lulzim Sadiku – Mendoj se nëse trafoja është sa më afër, që thuhet se është në oborr dhe të emërohet edhe një trafo tjetër, diçka jam i paqartë. Nëse, ajo trafo i nevojitet edhe komunitetit ne jemi pro kësaj që ndikon me vendim për komunitetin për të cilin po flasim, por jo të shkruhet për kolegjin amerikan kushdo që është ai. Kërkoj që nëse kjo çështje hudhet në votim, të hudhet si trafo e komunitetit, e jo për kolegjin amerikan.

Burim Gërguri – Sqaron se jepen 10 m² me u vendosë trafoja në shërbim të komunitetit për lagjen dhe biznesin në fjalë.

Lulzim Sadiku - Unë konkretisht jam kundër atyre, që do të paguhen dhe jam pro që secili kolegji, biznes i cili i ka përfitimet e veta të bën pagesën për tu shërbyer me tokën e Komunës. Përndryshe, jam pro qytetarit dhe jam kundër çdo kolegji që do të kërkon tokë në Komunën e Obiliqit, i cili paguhet për të gjitha shërbimet që i merrë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa nga “American School of Kosova” për vendosjen e trafos në pronën komunale me nr.të parcelës P-72614055-01790-26.

Burim Gërguri – ju njoftoj se kërkesa e Eljesa Terbunjës, meqë nuk ka kalue në KPF, sot nuk mund ta shqyrtojmë. Poashtu, kemi edhe një kërkesë nga Këshilli i Bashkësisë Islame, që të plotësohet KKSJ-ja me përfaqësuesin e tyre z. Irfan Hashani.

Lulzim Sadiku - Kërkoj që të gjitha kërkesat të cilat vijnë kryesues, të na i dërgoni me material që ne të

bëjmë një analizë më të thukët, ndërsa kërkesat të cilat vijnë në 72 orët e fundit, fare të mos parashihen në mbledhje.

Pas diskutimeve, kërkesat e cekura më lartë do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të KPF-së.

Lulzim Sadiku – Unë vijë nga lokacioni Sibofc, Hamidi, që lidhë edhe familjen Shehu dhe Shaljani dhe e kam një kërkesë prej këtij lokaliteti. Familja Shaljani, ka kërkuar që rruga nga Hamidia deri te xhamia të emërohet me emrin e një mësuesi i cili ka kontribue shumë, një ndër themeluesit e parë të Arsimit, e ai është Ahmet Halit Shehu.

Burim Gërguri – Sqaron se në mandatin e kaluar ka qenë një Komision për emërimin dhe rrimërimin e rrugëve dhe kjo është kryer. Familja në fjalë mund të bëjë kërkesë në DPUKP, dhe ata na rekomandojnë neve, se cilët janë hapat që ne mund ti ndjekim në Kuvend.

Lulzim Sadiku - Është fjala edhe për të njejtin mësues që kanë punue bashkarisht, është një Hasan Xhemajl Preniqi, që të gjithë nga fshati Hade, ma kanë dhënë një monografi të tyre dhe unë do ti informoj që ta sjellin kërkesën me shkrim, ashtu si po thoni ju.

Nazmi Gashi – Pyet lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar të anëtarëve të Kuvendit komunal të paraparë me plan të punës, a do të furnizohemi me llap top dhe me kartela identifikuese.

Burim Gërguri – Përgjegjet se me plan të punës është i paraparë udhëtimi dhe ne do të takohemi me përfaqësuesit e grupeve dhe me anëtarët e Kuvendit, të konsultohemi se kur doni me realizue udhëtimin. Llaptopët do të vijnë në shtator, por ne duhet të marrim një vendim që 3 asambleistët e mandatit të kaluar ti sjellin ata llaptop dhe ti marrin të ri. Ndërsa, për kartelat identifikuese drejtori i administrates, duhet të merret me këtë çështje.

Nora Preniqi – paraqet një kërkesë të banorëve të fshatit Mazgit, për mbulimin e Mazgitit të poshtëm dhe të epërm me shërbimin e transportit publik, me autobus. Gjatë kontakteve që kam me këtë komunitet ata vazhdimisht e parashirojnë këtë pyetje, se kur do të bëhemi me autobus.

Burim Gërguri – besoj se drejtori i DSHPE-së, do ta marrë në shqyrtim këtë çështje dhe do të japë përgjegje. Mirëpo, për fat të keq nuk është vetëm Mazgiti, por janë edhe 4,5 fshatra tjera të cilat kanë mungesë të shërbimeve të transportit publik,

Fatmir Bektashi – unë deshta ta bëjë pikë të rendit të ditës një kërkesë për transport, jo vetëm për Mazgitin, por për krejtë Komunën e Obiliqit. Ky problem pothuajse daton qe një dekadë. Në qeverisjen e kaluar ka drejtorë që janë prapë drejtorë aktual, që janë zotue se brenda 3 muajve ky problem do të zgjidhet dhe tani është viti i 5 dhe asgjë. Mendoj se drejtori i DSHPE-së, gjithsesi duhet të merret me këtë problem dhe drejtori i inspektoriatit, te i cili vetë personalisht e kam bërë një kërkesë, që 2 inspektorë të dalin, të legjitimojnë një kombibus, ose 2 kombibus. Mirëpo, ata nuk dalin që edhe paguhen për këtë punë dmth duhet të dalin. Propozoj të formohet një Komision, të harmonizohen oraret në krejtë Obiliqin dhe me shkuar në bashkëpunim me Prishtinën. Kjo duhet të jetë pikë e rendit të ditës, të prezentojnë të gjithë drejtorët në atë mbledhje dhe ata të merren me këtë punë. Mendoj se as Kryetari detalisht nuk është i njoftuar me këto probleme, që ekzistojnë në Komunën tonë. Poashtu, e kam një kërkesë për drejtorin e DSHPE-së, dhe e lus që të shkon te rr."Hoxhë Breznica" në Breznicë, për sanimin e gropave sepse është katastrofale.

Burim Gërguri - unë e di shqetësimin, i di vërejtjet, por do të mundohemi bashkarisht dhe besoj se me aprovimin e buxhetit për vitin 2019, kemi me pasë mundësi sepse kur kemi mjete mund të vendosim më lehtë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri